



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**

Nr. 8, Dt. 15.04.2009

*Per miratim te kerkeses per marrje leje, per perdorim uji, prej burimeve ujore te lumit te Smokthines per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC-it, te Smokthines, prej subjektit "Albanian Green Energy" sh.p.k, Tirane.*

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Albanian Green Energy" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per "Koncesionet", vendimit te K.M nr.27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt.19.07.2002 te K.K.U-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-it, te K.B.U –se dhe A.U-it, udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, Vendimit nr.467, dt. 03.10.2002 te K.M "Per miratimin e kontrates koncesionare te formes ROT", ndermjet Ministries te Indistrise Energjitikes dhe Ekonomise dhe nga ana tjeter shoqerise italiane Esegei, per HEC-et vendore, vendimit nr.148, dt. 22.03.2007, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne marreveshjen e koncesionit te formes ROT", lidhur ndermjet Ministries te Energjitikes Ekonomise dhe Industrise dhe shoqerise italiane Esegei nga ana tjeter, dhe vendimit nr.69, dt. 12.12.2007, per shqyrtimin e transferimit te licences nga shoqeria H.C.A sh.p.k, tek shoqeria Ballkan Green Energy sh.p.k, dhe vecanerisht vendimit nr.70, dt.10.12.2007, per shqyrtim dhe transferim te licences nga shoqeria "Essegei Shqiperi Smokthina" sh,p,k tek shoqeria "Albanian Green Energy" sh.p.k,

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e kerkeses te bere nga shoqeria "Albanian Green Energy" sh.p.k, Tirane per leje, "Per perdorim te ujit" per prodhim te energjise elektrike, Nepermjet HEC-it te Smokthines, ne lumin e Smokthine.
- 2- Vepra e marrjes, do te jete ne vendin, (ku eshte sot) me koordinata,  
X = 44 64 275      Y = 43 95 725      Z = 412 m
- 3 - Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise, per HEC-in e Smokthines (ne Lepenice) do te jete 6 m<sup>3</sup>/sek.

• **Vazhdim i Vendimit nr.8, dt.15.04.2009**

- 4 – Periudha e perdorimit te ujit do te jete gjate gjithë vitit, perjashto periudhen nga 1 Maj deri ne 31 Gusht te cdo viti, ku prurjeve te mesiperme te ujit, do tu zbriten sasia e ujit qe do te perdoret per ujitjen e kulturave bujqesore - 0.2 m<sup>3</sup>/sek.
- 5 - Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.
- 6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJESI I A.U.B “VJOSE”**

**Vezir METAJ**



**KRYETARI I K.B.U “VJOSE”**

**Hasan HALILI**

